| **12** | *Ndërrimi i përçuesit izolatorëve dhe paisjeve lidhëse në LP 125/2 dhe 125/3* | 2,389,000.00 € | KOSTT | 1.959.800.80€ | 01.06.2011 | 20.12.2011 | ELSA&UKAB (Si/RKS) | 293,970.12 € | Projekti është në fazën e dizajnimit. Është dorëzuar dokumentacioni që është kërkuar nga KOSTT-i dhe është bërë analiza gjeologjike e tokës, mirëpo rezultate ende nuk i kemi marr. Është caktuar traseja dhe janë bërë matjet gjeodezike të trasës së linjës. Është filluar me demontimin e linjës LP 125/2 dhe është duke u përgaditur dokumentacioni i domosdoshëm që të aplikojmë për marrjen e lejës për ndërtimin (rekonstruktimin) e kësaj linje. Mbrenda muajit shtator është caktuar që të mbahet mbledhja e dytë ku do të analizohet përparimi i realizimit të këtij projekti. Është punuar në segmetin e linjës ku nuk ka probleme pronësore, gjithashtu në | Që dokumentacioni i kërkuar të jetë plotësisht sipas kërkesave të KOSTT-it |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | bazë të këkesës së Ministrisë së Ambientit dhe të Mjedisit, dokumentacioni për marrjen e Lejes Urbanistike dhe Ndërtimore është kërkuar të sillet në gjuhën shqipe. Kontraktuesi ka marrë për detyrë që në afatin sa më të shkurtër ta sjell dizajnin konform ligjeve ne fuqi, për marrjen e Lejes Urbanistike dhe Ndërtimore. | |
| **13** | *Kycja e NS Lipjanit në linjën LP 212 ( Kosova A - Ferizaj 2)* | 1,050,000.00 € | KOSTT | 1,397,094.32 € | 27.06.2011 | 27.07.2012 | UMEL (B&H) | 209,564.21 € | Projekti është në fazën e dizajnimit bazik dhe detal. Nga ana e kontrkatuesit janë bërë disa matje gjeodezike dhe është caktuar korridori për trasenë e linjës.<br>Nga ana e kontraktuesit është përgatitur elaborati për shpronësimin e trasesë së linjës (vendi ku do të ndërtohen shtyllat). Konform këtij elaboorati dhe dizajnit të aprovuar për ndërtimin e linjës dhe konform ligjeve në fuqi është bërë aplikimi për marrjen e Lejes Urbanistike dhe Lejes Ndërtimore në Minsitrinë e Planifikimite Hapësinor dhe Mjedisit. | Që dokumentacioni i kërkuar të jetë plotësisht sipas kërkesave të KOSTT-it |
| **14** | *Ndërrimi i Mbrojtjeve Rele në NS 110/35kV Prishtina 2 dhe Prishtina 3* | 250,000.00 € | KOSTT | 168,880.32 € | 11.07.2011 | 02.01.2012 | KONCAR-KET (Hr) | 25,332.05 € | Projekti është në fazën e dizajnimit bazik dhe detal. Është mbajtur takimi i parë dhe i është kërkuar kontraktuesit Koncar që t'i përmbahet kërkesave të KOSTT- it në lidhje me dokumentacionin para se të fillohet me realizimin e projektit. Kontraktuesi ka sjellur dolumentacionin e kërkuar nga ana e KOSTT-it , të cilin dokumentacion e kemi aprovuar. | Të vazhdohet me aktivitetin e filluar. |
| **15** | *Rehabilitimi në linjat 110kV, 126/4 (pjesa e vjetër), 179/1, 1801 (ndërrimi i izolatorëve dhe urave përçuese)* | 150,000.00 € | KOSTT | 51,976.60 € | 25.09.2011 | 17.12.2011 | ELEGANCA (RKS) | 0.00 € | Projekti është në fazën e dizajnimit bazë dhe detal.<br>Pengesë në realzimin e projektit mund të paraqitet sigurimi i shkyçjeve të linjave përkatëse; në veçanti i Linjes 110 kV, nr. 1801, linjë kjo që furnizon NS Palaj (Mihjet) nga NS Kosova A. | Rekomandohet që të krijohen kushte për punë për kontraktuesin, nga Departamenti i Operimit te Sistemit dhe KEK, në mënyrë që mos të kemi vonesa në kompletimin e projektit. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **16** | *Ndarja e zbarrave në dy seksione* | 150,000.00 € | KOSTT | 36,951.57 € | 09.08.2011 | 27.01.2012 | UKAB | 0.00 € | Është nënshkruar kontrata , projekti është në fazën e fillimit; përgatitjes së dizajnit bazë. | |

## 2.5. Shqyrtimi i performancës financiare

## 2.5.1. Draft Pasqyrat Financiare: BILANCI I GJENDJES

| | Nota | Janar-Shtator/2010 | Janar-Shtator/2011 | % |
|---|---|---|---|---|
| **ASETETE JO QARKULLUESE** | | **80,771,477** | **94,774,806** | **117.34%** |
| Prona, Fabrika dhe Paisjet | 4 | 64,272,204 | 72,348,069 | **112.57%** |
| Investimet në vijim | 5 | 16,499,273 | 22,426,737 | **135.93%** |
| **ASETET QARKULLUESE** | | **33,501,045** | **34,908,942** | **104.20%** |
| Stoqet,pjesët rezervë dhe veglat | 6 | 684,333 | 1,191,980 | **174.18%** |
| Kërkesat | 7 | 10,163,071 | 6,752,349 | **66.44%** |
| Kredi,Avanse dhe Depozita | 8 | 8,147,216 | 6,092,114 | **74.78%** |
| Tatimi i Parapaguar | | 300,000 | 171,867 | **57.29%** |
| Paraja dhe Bilanci Bankar | 9 | 14,206,425 | 20,700,631 | **145.71%** |
| **TOTALI I MJETEVE** | | **114,272,522** | **129,683,748** | **113.49%** |
| **KAPITALI I AKSIONARËVE DHE REZERVAT** | | **43,898,923** | **46,333,073** | **105.54%** |
| Kapitali Aksionar | 10 | 25,000 | 25,000 | **100.00%** |
| Kapitali i trashëguar | 11 | 28,346,963 | 28,346,963 | **100.00%** |
| Fitimi i mbajtur | | 10,784,880 | 14,084,667 | **130.60%** |
| **Fitimi aktual** | | 4,742,080 | 3,876,443 | **81.75%** |
| **OBLIGIMET JO QARKULLUESE** | | **62,192,648** | **75,707,750** | **121.73%** |
| Të hyrat e shtyera | 12 | 62,192,648 | 75,707,750 | **121.73%** |
| **OBLIGIMET QARKULLUESE** | | **8,180,951** | **7,642,925** | **93.42%** |
| Obl.nga tregtia dhe obl.tjera | 13 | 8,180,951 | 7,642,925 | **93.42%** |
| **TOTAL BURIMET E MJETEVE** | | **114,272,522** | **129,683,748** | **113.49%** |

## 2.5.2. DRAFT PASQYRA E FITMIT DHE HUMBJES

| | Nota | Plani Janar-Shtator. /2010 | Janar-Shtator/2010 | % real/plani 2010 | Plani Janar-Shtator /2011 | Realiz. Janar-Shtator/2011 | % real/plani 2011 | % realiz 2011/2010 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Të hyrat nga tarifa | 15 | 13,496,178 | 14,299,561 | 105.95 | 11,050,823 | 11,420,255 | 103.34 | **79.86%** |
| Të hyrat tjera | 16 | 0 | 1,942,694 | | 2,189,970 | 2,891,679 | 132.04 | **148.85%** |
| **Të hyrat totale** | | **13,496,178** | **16,242,255** | 120.35 | **13,240,793** | **14,311,934** | 108.09 | **88.12%** |
| Shpenzimet e personelit | 17 | 1,982,439 | 1,840,295 | 92.83 | 1,873,913 | 1,959,786 | 104.58 | **106.49%** |
| Shpenzimet e materialit | | 39,000 | 23,662 | 60.67 | 39,000 | 28,794 | 73.83 | **121.69%** |
| Rregullimi sekondar | | 1,217,925 | 747,000 | 61.33 | - | - | | 0.00% |
| Amortizimi | 4 | 3,466,640 | 4,270,886 | 123.20 | 3,899,970 | 4,170,058 | 106.93 | **97.64%** |
| Energjia,telofoni, uji | | 149,385 | 153,971 | 103.07 | 181,560 | 164,386 | 90.54 | **106.76%** |
| Riparime dhe mirëmbajtje | 18 | 739,397 | 576,698 | 78.00 | 879,787 | 567,914 | 64.55 | **98.48%** |
| Derivate dhe lubrifikante | | 69,901 | 46,278 | 66.21 | 69,902 | 65,566 | 93.80 | **141.68%** |
| Medicina,siguria dhe transporti | 20 | 164,550 | 183,120 | 111.29 | 234,000 | 156,278 | 66.79 | **85.34%** |
| Shpenzimet tjera operative | 19 | 585,752 | 522,656 | 89.23 | 962,510 | 508,681 | 52.85 | **97.33%** |
| Kompenzimet tjera. | | 69,750 | 93,791 | 134.47 | 75,000 | 86,638 | 115.52 | **92.37%** |
| Humbjet në bartje | 21 | 3,927,175 | 3,041,818 | 77.46 | 3,191,855 | 2,727,390 | 85.45 | **89.66%** |
| **Shpenzimet totale** | | **12,411,914** | **11,500,175** | 92.65 | **11,407,497** | **10,435,491** | 91.48 | **90.74%** |
| **Fitimi para Tatimit** | | **1,084,264** | **4,742,080** | 437.35 | **1,833,296** | **3,876,443** | 211.45 | **81.75%** |
| Tatimi ne fitim | 22 | | - | | | | | |
| **Fitimi për periudhë** | | **1,084,264** | **4,742,080** | 437.35 | **1,833,296** | **3,876,443** | 211.45 | **81.75%** |

## 2.5.2. Analiza e IKP-ve financiare

IKP-të financiare të zgjedhura për të paraqitur performancën financiare të KOSTT-it, janë të matshëm në baza vjetore dhe në baza kuartale. Indikatorët e paraqitur në këtë tabelë janë të matshëm në baza kuartale.

| Treguesit | I-IX 2010 | I-IX 2011 | Spjegimet |
|---|---|---|---|
| **T1. Fitimi operativ margjinal** = Fitimi neto /gjithësejt të hyrat | 0.29 | 0.27 | Qëllimi është që të jetë mbi zero.<br>Është treguesi i cili më së miri paraqet nivelin e të hyrave nga operacionet vijuese.<br>Ky tregues matë se çfarë përqindje e të hyrave të kompanisë, mbetet pasi që ajo t'i paguaj të gjitha shpenzimet variabile si: pagat, materialet, shërbimet, etj.<br>Sa më i lartë është ky tregues, kompania është në gjendje më të mirë. |
| **T2. Treguesi i qarkullimit** = asetet qarkulluese/detyrimet qarkulluese | 4.09 | 4.57 | Tregon aftësinë e kompanisë për t'i përmbushur obligimet e saj afatshkurtëra, me mjetet (asetet) e saj afatshkurtëra. Optimalja e këtij treguesi është **1.5**. |
| **T4. Mbulimi i shp.operative** = gjith.të hyrat/shpenzimet operative | 1.41 | 1.37 | Tregon raportin e të hyrave dhe shpenzimeve operative të realizuara Treguesi duhet të jetë **më i madh ose =1** |
| **T5. Mbulimi i të hyrave** = gjiths.të hyrat/ shpenzimet e lejuara | 1.10 | 1.06 | Treguesi duhet të jetë **më i madh ose =1** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **T6. Mbulimi i shp. të lejuara =** shpenzimet e lejuara/gjithësejt të hyrat | 0.91 | 0.95 | Treguesi duhet të jetë **më i vogël se 1 ose =1** |
| **T7.Gjith.të hyrat ndaj të hyr.të lej =** gjiths.të hyrat e rregulluara/të hyrat e lejuara | 1.20 | 1.24 | Këtu vihen në raport vetëm të hyrat e rregulluara të realizuara dhe të hyrat e lejuara.Treguesi duhet të jetë **=1.** Për shak të rrjedhave më të mëdha të energjisë, treguesi është më i madh se 1. |
| **T12. Shpenzimet e lejuara për GWh e transmetuara** | 3.74 | 2.14 | Ky indikator ndërlidhet me metodologjinë e tarifave të ZRrE-së, e cila për periudhën raportuese ka lejuar shpenzimet totale për njësi 2.14 m €/GWh.<br>Ky indikator tutje analizohet duke iu referuar treguesit **T14**, që paraqet shpenzimet totale (të realizuara) për njësi, ku shihet se KOSTT ka transmetuar energji me shpenzimet reale 1.65 m €/GWh. |
| **T13. Të hyrat e lejuara për GWh e transmetuara** | 3.43 | 1.82 | Paraqet të hyrat për njësi.<br>Objektivi: Efikasiteti në terma relative të shpenzimeve që i referohen humbjeve teknike |
| **T14. Shpenzimet totale për njësi =** shpenzimet totale/GWh e transmetuara | 2,92 | 1.65 | Objektivi: Efikasiteti në terma relative të shpenzimeve që i referohen humbjeve teknike. |

## 3. Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore

| Nr. | Lënda nr. | Pranë | Objekti i kontestit | Vlera e kontestit | Statusi | Statusi | |
| --- | --- | --- | --- | --- | --- | --- | --- |
| 1 | Lënda Civile nr. 2248/03 | Gjykata Komunale në Prishtinë | dëmshpërblim për lëndim në vendin e punës | 92,000.00 | Seanca me dt.23.03.2009. KOSTT ka kërkuar që lënda ti dërgohet KEK-ut për shkak të kompetencës. | Seanca e caktuar për dt.14.07..2009, u mbajt me vonesë, KOSTT ia ka dorëzuar Përgjigjen në Padi Gjykatës dhe në seancë në tërësi hedh poshtë kërkesëpadinë e Paditësit si të pabazë.Pritet Akgjykimi. | Seanca 01.04/11, shtyhet, seanca e dt.21.04 për dt.12.05/11. |
| 2 | Lënda penale nr.326/05 | Gjykata Komunale në Kaçanik | vjedhje | 2,370.00 | Seanca e rradhës u caktua për datën 18.11.2008; shtyhet 30.01;shtyhet 30.03.2009... | Seanca e përfundimtare me dt.17.03/09, ështe mbajtë Aktgjykimi.-është pranu, Lënda me Ankesë nga Prokurori të dt.08.04.2009) | Verifikimi i fundit i lëndës-29.06/10, ende e pakryer. |
| 3 | Lënda Civile nr.85/05 | Gjykata Komunale në Prishtinë | kompensim i dëmit | 50,000.00 | Seanca e rradhës është caktuar për datën 24.12.2008 | Seanca e rradhës ështe caktuar për dt.10.02.2009, Mbahet seanca përfundimtaredt.11.06.2009.Refuzohet Kërkesëpadia e Paditësit. | Lënda me Ankesë në GjQ. |
| 4 | Lënda civile C1.nr.505/07 | Gjykata Komunale në Prishtinë | pagesa e kamatës ligjore | nuk ka | Përfaqësuesi i KEK-ut, ka refuzuar pjesëmarrjen në seanca pa prezencën e KOSTT-it. | Është caktuar seanca me dt.01.04.2009,shtyhet. KOSTT parashtron Ankesë ne GjQ-Pr, kundër Aktgjykimit C1 505/07. Seanca e rradhës, dt.06.05.2010. | Aktgjykimi nuk është i formës së prerë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | Lënda penale nr. 2406/ 06 | Gjykata Komunale në Prishtinë | vjedhje | **15,398.00** | Aktgjykimi në favor të KOSTT-it por nuk është bërë akoma i plotfuqishëm | Nuk kemi njoftim ende për formën e prerë. | Verifikim me dt.11.06/09, Aktgjykimi nuk i është dorëzuar të Paditurve, nga dt12.06, do t'i dorëzohet me polici |
| 6 | Lënda penale nr.320/06 | Gjykata Komunale në Kaqanik | vjedhje e rëndë | **9,120.00** | Seanca e rradhës është caktuar për datën 14.11.2008 | Seanca e caktuar për dt.27.01.2009 është mbajtur dhe pritet Aktgjykimi | Aktgjykimi me Ankesë, ne GjQ, nga dt.19.03/09 Verifikimi i fundit 29.06.2010. |
| 7 | Lënda penale 284/06 | Gjykata Komunale në Lipjan | vjedhje e rëndë | Nuk është përcaktuar | KOSTT ka ushtruar Ankesën për zgjedhje të pjesërishme (vlera e kontestit) | | .Lënda me Ankesë, pritet përgjigja nga Gjykata e Qarkut. |
| 8 | Lënda civile nr. 409/06 | Gjykata Komunale në Prishtinë | Lirimi i banesës | nuk ka | Seanca e rradhës nuk është mbajturur, pritet caktimi i seancës tjetër | Seanca e caktuar gabimisht nga Gjykata me dt.04.01/10(ditë pushimi). | Seanca e rradhës nuk është caktuar ende. |
| 9 | Lënda civile nr.511/00 | Gjykata Komunale në Prishtinë | lirimi i lokaleve në Kurriz | nuk ka | Kontesti ka përfunduar pozitivisht për KOSTT-in. Pritet Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë | Aktgjykimi është marrë, në proces është propozimi për ekzekutim. | Ende nuk është kryer.(Paraprakisht marrëveshja me palët për lirim të Lokaleve). Lënda me Ankesë GjQPr. |
| 10 | Lënda civile nr. 2168/04 | Gjykata Komunale në Prishtinë | lirimi i lokalit nga gjellëtorja në Kurriz | nuk ka | Seanca e rradhës u caktua për datën 19.11.2008 | Dalja në vend me Gjykatën, dt.23.04/09, pritet Raporti i Ekspertit. | Seanca e rradhës më 17.04/09,(Përfaqëson KEK-u). Pengohet puna e Ekspertit nga Pala. Njoftohet Gjykata |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 11 | Lënda civile C.nr.588/08 | Gjykata Komunale në Gjakovë | Kompenzim dëmi | **1719.04** | Seanca u caktua për dt.19.01.2009 | Seanca e rradhës në afat të pacaktuar | KOSTT, sipas Aktvendimit C.nr.136/09 paraqet përgjigje në Padi, me dt.28.04.2009. |
| 12 | C.156/09 | Gjykata Komunale Prizren | Kompenzim dëmi | | I parashtruar me dt.11.03/09. | | Pritet caktimi i seancës së radhës. |
| 13 | Lëndë Civile C.nr.442/09 | Gjykata Komunale-Prizren | Pengim posedi | 500 | … | Seanca mbahet dt.11.11/09,11,30h; shtyhet 02.12/10;14.12; 25.05…e fundit dt.07.06/11. | Gjykata bie Aktgjykim në favor të KOSTT, dt.15.07.2011. Lënda me Ankesë në GJQ. |
| 14 | Lëndë civile , Padi | Gjykata Komunale Ferizaj | kompenzimi i dëmit | 200,00€ | Padia e dorëzuar në Gjykatë ,26.06/09 | Pritet caktimi i seancës. | |
| 15 | C.nr.1559/06 | Gjykata Komunale Prishtinë | pagesa e Rentës. | | KEK ka paguar - Qershor/2006. | Seanca e 06.05; 04.06, 08.07 dhe shtyhet 26.10/10 | KOSTT ka dhënë dëshminë mbi legjitimitet pasiv. |
| 16 | C.nr. 270/07 | Gjykata Komunale Podujevë | Kompenzim dami | **100.000,€** | KOSTT- I padituri III-të (Tretë) | seancat e dt:10.09; dhe 12.10/10 dorëzimi i shkresave të lendës KOSTT-it | Seanca e radhës sipas ftesës. |
| 17 | A.nr.888/10 | Gjykata Supreme e Kosovës | Vlersimi për TP | **14.000,€** | Ankesa e KOSTT-it pjesërisht e aprovuar nga Bordi Komunal. | KA i parashtruar në afat ligjorë | Gjyqtarja e çështjes në pushim të zgjatur. |
| 18 | C.nr.218/11 | Gjykata Komunale Ferizaj | Pengim Posedi | 500 € | KOSTT- ka parashtrua Përgjigje në Padi sipas Aktvendimit të Gjykatës | | Seanca e dt.20.06.11 shtyhet me 04.07;shtyhet me 05.09.11, Seanca e rradhës me 27.10.11 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 20 | C.nr.503/11 | GJYKATA Komunale Pejë | Pengim Posedi | nn | Sipas kërkesës së Gjykatës, KOSTT ka parashtrua precizimin e Padisë. | Pritet ftesa për seancë(para seancës sqarime me Gjyqtarin F.Baloku) | |
| 21 | C.nr.2255/06 | GjK-Prishtine | Kompenzim dami | nn | Sipas kërkesës së të Atorizuarit të Paditëses me zgjerim të Padisë | Seanca pas Ftesës Gjyqësore | |

**Vërejtje:**

Lënda civile nr. 32/08, me Aktvendim 217/08 është e kryer me Ujdi Gjyqësore dhe Aktvendim Gjyqësor.
Lënda C.nr.503/11 dhe lënda C.nr.2255/06 janë lëndë të reja.

# 4. Kontratat/transakcionet e konsiderueshme gjatë tremujorit të tretë të vitit 2011 nga burimet e KOSTT

| Nr | Dep | Lloji i prokurimi | Emri i prokurimit | KONTRAKTORËT | LOT | Kodi buxhetor | Vlera e kontratës | Vlera e realizuar e kontratës | Vlera e parealizuar e kontratës | Kontrata | realizimi ne % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Departamenti për Menaxhim të Projekteve&Inxhinieri | Furnizim | Kyçja e NS Lipjanit në linjën LP212 (Kosova A – Ferizaji) | Umel Dalekovodmontaza | | 023/7 | 1,397,094.72 € | 209,564.21 € | 1,187,530.51 € | nr.194 dt.01.06.2011 | 15.00% |
| 12 | Deparamenti i OT | Furnizim | Furnizimi dhe montimi i shkarkuesve të mbitensionit në LP 400kV | ABB d.o.o. Zagreb | | 5320/1 | 100,799.06 € | - € | 100,799.06 € | nr.195 dt.01.06.2011 | 0.00% |
| 13 | Departamenti për Menaxhim të Projekteve&Inxhinieri | Shërbime | Ndërrimi i mbrojtjeve Rele në NS | Koncar Power Plant- Zagreb | | 023/2 | 168,880.32 € | 25,332.05 € | 143,548.27 € | nr.222 dt.21.06.2011 | 15.00% |
| 14 | Departamenti për Menaxhim të Projekteve&Inxhinieri | Furnizim | Ndërrimi i përçuesit, izolatorëve dhe pajisjeve lidhëse në LP: 125/2,125/3 | konz.ELSA & UKAB | | 023/5, 023/9 | 1,959,800.80 € | 425,198.60 € | 1,534,602.20 € | nr.200 dt.08.06.2011 | 21.70% |
| 15 | Deparamenti i OT | Furnizim | Rehabilimi në linjat 110kV, LP 126/4(pjesa e vjetër), LP 179/1 dhe LP1801 | konz.ELBNDERTUESI&ELEGANCA | | 5320/2 | 51,979.60 € | - € | 51,979.60 € | nr.217 dt.20.06.2011 | 0.00% |
| 25 | Deparamenti i OT | Furnizim | Furnizim me pjese rezerve per mirembajtje te linjave dhe nenstacioneve | UKAB | | 5320/3 | 185,397.80 € | 27,809.68 € | 157,588.12 € | nr.229 dt.06.07.2011 | 15.00% |
| 27/2010 | Departamenti për Burime Njerzore | Shërbime | Sigurimi Fizik i Objekteve të KOSTT sh.a | LEO SECURITY | | | 338,791.68 € | 52,430.36 € | 286,361.32 € | nr.88 dt.21.03.2011 | 15.48% |
| 37/2010 | Departamenti për Burime Njerzore | Furnizim | Dizajnimi, Zhvillimi dhe Implementimi i Aplikacionit për Udhëheqjen dhe Mirëmbajtjen e Aseteve | Inovativi | | | 174,990.00 € | - € | 174,990.00 € | nr.71 dt.03.03.2011 | 0.00% |
| 39 | Zyra për SI dhe MKZ | Shërbime | Kontrollimi dhe servsimi i aparateve zjarrfikëse | PASTOR KOSOVA | | 5329/19 | 50,000.00 € | - € | 50,000.00 € | nr.260 dt.07.09.2011 | 0.00% |
| 39/2010 | Departamenti për Burime Njerzore | Punë | Renovimet e EKCS-NS Kosova B për nevoja të projektit të SCADA | Ndertimtari | | | 49,780.16 € | - € | 49,780.16 € | nr.74 dt.15.03.2011 | 0.00% |
| | | | | Totali → | | | 4,477,514.14 € | 740,334.90 € | 3,737,179.24 € | 16.53% | 16.53% |

# Shtojca 1: Raport mbi funcionimin e Qeverisjes Korporative të KOSTT-it

Raporti mbi funcionimin e Qeverisjes Korporative përfshin aktivitetet e Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it që kryhen bazuar në Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Statutin e Kompanisë dhe Rregullorën e Punës së Bordit.

Ky Raport gjithashtu përfshinë edhe punën e Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të tjera të themeluara nga Bordi.

Për periudhën raportuese Korrik – Shtator 2011 Bordi ka mbajtur 2 (dy) mbledhje, një të rregullt dhe një të jashtëzakonshme, kurse Komisioni i Auditimit ka mbajtur 1 (një) mbledhje të rregullt. Gjatë kësaj periudhe, edhe Komisioni i Bordit për Linjën 400 kV Kosovë-Shqipëri ka mbajtur (1) një mbledhje, kurse Komisioni i Projekteve Kapitale i themeluar nga Bordi i Drejtoreve të KOSTT-it gjithashtu ka mbajtur 1 (një) mbledhje. Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it ka qenë i kyçur në të gjitha aktivitetet e natyrës strategjike të KOSTT-it.

Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit janë mbajtur në periudhat kohore sipas Planit të aprovuar të Punës së Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit për vitin 2011.

Çdo mbledhje e rregullt e Bordit ka trajtuar disa pika që paraqiten në çdo mbledhje të Bordit si pika të rëndomta dhe përfshijnë: vërtetimin e kuorumit dhe aprovimin e rendit të ditës, aprovimin e procesverbaleve nga mbledhjet paraprake të Bordit të Drejtorëve dhe të Komisioneve. Mbledhjet në vijim janë paraqitur sipas datës së mbajtjes së tyre.

## 1. Mbledhja e Komisionit të Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it për Projektet Kapitale

Komisioni i Bordit për Projektet Kapitale me datën 14 Shtator ka mbajtur mbledhjen e vet të 5- të..Bordi është njoftuar për zhvillimin në projektin SCADA/EMS & Telekomi. Projekti është pranuar teknikisht nga Komisioni për Pranim Teknik Intern, pa pjesën e projektit që ishte dashur të zhvillohet në pjesën veriore të Kosovës (gjegjësisht në NS Vallaq dhe NS Ujman), për shkak të situatës politike dhe të sigurisë

atje. Sistemi i Komandimit dhe Monitorimit dhe Sistemi i Telekomit (SCADA/EMS & Telekomi) është në operim.

Bordi u njoftua nga menaxhmenti i KOSTT-it për problemin e mos ndërtimit të Linjës së dyfishtë 110 kV, NS Peja 3 – NS Skenderaj (rasti i ndërtimit të shtyllës në pronën e Kompanisë "Vëllezërit Geci") dhe se nuk ka ndonjë progres në këtë drejtim, përkundër angazhimit të menaxhmentit të KOSTT-it për zgjidhjen e këtij problemi. Rrezik paraqitet edhe mundësia e paraqitjes së gjobitjes (penalltive) nga ana e kontraktuesit, për mossigurim të kushteve për zbatimin e projektit, konform kontratës. Shtylla është lejuar të ngritet, por lidhja e përçuesve në mes shtyllës nr. 1 dhe 2 nuk po lejohet nga pronarët e Kompanisë "Vëllezërit Geci", që pamundëson energjizimin e nënstacionit NS Skenderaj. Kjo situatë e krijuar është e papranueshme, pasi gjatë sezonit të dimrit, qytetarët e Komunës së Skenderajt, do të përballen me mungesë të furnizimit me energji elektrike 33% më pak se vitin e kaluar, si pasojë e instalimit të fushës transformatorike 10 (20) kV për transformatorin energjetik 31.5 MVA. Në lidhje me këtë, Komisioni për Projekte Kapitale vendosi që edhe njëherë t'i rekomandohet Bordit dërgimi i një letre zyrtare instancave më të larta relevante vendimmarrëse në Kosovë, pasi që këto dy probleme tejkalojnë kompetencat e Bordit.
.

Bordi është informuar në lidhje me Paket Projektin Ferizaj 2, i cili në LOT1 NS Ferizaj 2 është duke u implementuar sipas dinamikës së paraparë me planin dinamik dhe nuk ka ndonjë vështirësi në këtë drejtim.
LOT2 Linjat 400 dhe 110 kV: Projekti i Ndërtimit të Linjave 400 & 110 kV për NS Ferizaj 2 është gjithashtu duke rrjedhur sipas dinamikës së paraparë, në ndërtimin e shtyllave e me këtë edhe të linjave përkatëse, me gjithë vështirësitë që KOSTT-i i ka në zgjidhjen e çështjeve pronësore – juridike me pronarët e tokave, ku do të ndërtohen shtyllat për linjat përkatëse, konform elaboratit të shpronësimit. Problemet kryesore paraqiten në vendbanimet e Komunë së Gjilanit.

Bordi gjithashtu është njoftuar në lidhje me projektin - Rindërtimi i NS 220/110 kV – Prizreni 2 i cili po zhvillohet sipas planit dinamik dhe nuk ka ndonjë problem në këtë drejtim.

Bordi u njoftuar për vështirësitë dhe pengesat në realizimin e projekteve veçanërisht gjatë ndërtimit të objekteve elektro-energjetike, me theks të posaçëm të linjave transmetuese; në procedurat e marrjes së Lejes Urbanistike dhe Lejes Ndërtimore dhe në shpronësimin e tokave, ku do të ndërtohen shtyllat e linjave përkatëse.

**2. Mbledhja nr. 04/11 e Komisionit për Linjën 400 kV Kosovë – Shqipëri**

Komisioni për Linjën 400 kV Kosovë – Shqipëri ka mbajtur mbledhjen e radhës me datën 03 Gusht 2011 . Komisioni ka vlerësua informatën për zhvillimet në realizimin e Projektit të Linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri si dhe me detyrat e mëtejme. Komisioni është informuar nga menaxhmenti i KOSTT-it në lidhje me aktivitetet komercialo-financiare në lidhje me projektin. Marrëveshja rreth pengut për garantimin e të hyrave nga transiti dhe Marrëveshja e pengut për garantimin e parave të gatshme për servisimin e huasë janë firmosur me KfW-në ashtu si janë paraparë me Marrëveshjen për financim dhe kredi të lidhur në mes të KEK-ut dhe KfW-së.

Pas diskutimeve dhe sqarime shtesë për projektin e Linjës 400 kV Kosovë - Shqipëri, anëtarët e Komisionit dolën me përfundimin se procesi rreth projektit të Linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri është në rrjedhjë të mirë dhe nuk ka ndonjë gjë serioze që mund ta dëmtojë këtë proces. Menaxhmenti i KOSTT-it inkurajohet për vazhdimin e punëve në realizimin e këtij projekti me një rëndësi të madhe.

**3. Mbledhja e Komisionit të Auditimit nr. 21/11** 21/11 e dt. 22 gusht 2011

Komisioni i Auditimit në mbledhjen e mbajtur më 22 Gusht 2011 ka shqyrtar Raportin tremujor të KOSTT-it për periudhën Prill-Qershor 2011. Bordi ka konstatuar se Raporti i prezantuar i ka përmbushur kërkesat sipas IKP-ve dhe se ana financiare e raportit e shpreh arritjen e objektivave të parashikuara të kompanisë. Menaxhmenti i KOSTT-it ka dhënë shpjegime për disa pika të Raportit të cilat ishin në interesim të anëtarëve të Komisionit të Auditimit.

Si pjesë e raportit tremujor Prill-Qershor 2011 është prezantuar edhe pjesa e veçantë e Raportit në lidhje me të arriturat, pengesat dhe sygjerimet. Komisioni i Auditimit pas diskutimeve ka konstatuar se Raporti tremujor për periudhën Prill-Qershor 2011 është i përpiluar konform rregullativës ligjore, standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe i përmbush të gjitha kriteret për shqyrtim nga Bordi i Drejtorëve.
Komisioni i Auditimit ka rekomanduar që Raporti Tremujor Prill-Qershor për vitin 2011 t'i prezantohet Bordit për shqyrtim dhe aprovim.

Komisioni i Auditimit ka shqyrtuar dhe analizuar Letrën e Menaxhmentit të përgatitur nga Auditori i Jashtëm KPMG dhe ka propozuar që e njëjta t'i dërgohet Bordit për shqyrtim.

Komisioni i Auditimit u informua për Raportin nga konsulentja e NJPMNP për vlerësimin e Bordit të KOSTT-it.

Komisioni i Auditimit u informua me vendimin e Qeverisë për transferimin e aseteve 110 kV nga KEK në KOSTT. Komisioni u informua mbi pritjen e planit aksional nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik e cila do të definojë procesin e transferimit të aseteve ekzistuese, derisa KOSTT ka definuar hapat dhe është në përgatitje e sipër të Draft Marrëveshjes që do të lidhet në mes të KEK-ut dhe KOSTT-it bazuar në Vendimin e Qeverisë për transferimin e përmendur.

**4. Mbledhja e Rregullt e Bordit nr. 21/11 më 24 GUSHT 2011**

Bordi në mbledhjen e rregulltë të tij me 24 Gusht 2011 është informuar me çështjet aktuale nga periudha raportuese nga Kryshefi Ekzekutiv i KOSTT-it.
Bordi gjithashtu ka shqyrtuar dhe aprovuar Raportin Tremujor të KOSTT-it për periudhën Prill-Qershor 2011. duke vlerësuar se Raporti i përmban të gjitha elementet konform dispozitave ligjore, është gjithëpërfshirës dhe janë paraqitur të gjithë IKP-të teknike dhe financiare të cilët tregojnë afarizëm pozitiv të KOSTT-it në 6 mujorin e parë të vitit 2011.
Bordi ka shprehur brengosje për një tendencë të ndryshimit që mund të ndodh në të ardhmen për shkak të zvogëlimit të tarifave nga ana e Zyrës së Rregullatorit të Enegjisë.

Bordi ka shqyrtuar Letrën e Menaxhmentit, të përgatitur nga auditori i jashtëm KPMG dhe ka udhëzuar menxhmentin e KOSTTT-it që të përgatis përgjigjet dhe të përkthehet në gjuhën shqipe.

Bordi është informuar me raportin nga konsulentja e NJPMNP për vlerësimin e Bordit. Bordi ka shprehur kënaqësinë për vlerësimin e Bordit me performancë shumë të mirë dhe ka konstatuar se Raporti është produkt i punës së Bordit dhe i shërbimeve profesionale të KOSTT-it. Raporti si i tillë, do të shërbej si mirënjohje e organizimit të Bordit për punën sipas standardeve ndërkombëtare.

Bordi gjithashtu është informuar për fillimin e punëve dhe orarin e aktiviteteve për implementimin e Vendimit të Qeverisë për transferin e aseteve 110 kV nga KEK në KOSTT. Bordi ka pranuar me kënaqësi vendimin dhe ka shprehur mirënjohje për vendimmarrësit dhe se vendimi është mjaft i favorshëm për KOSTT dhe interesat e konsumatorëve të Kosovës në përgjithësi për finalizimin e aseteve për një afarizëm të suksesshëm të KOSTT.
Bordi ka shqyrtuat dhe aprovuar Procesverbalin nga mbledhja e Komisionit për ndarjen e aseteve KOSTT-KEK dhe Procesverbalin nga mbledhja e Komisionit për linjën 400 kV Kosovë-Shqipëri.
Bordi ka shqyrtuar dhe analizuar Letrën e Menaxhmentit të përgatitur nga Auditori i Jashtëm KPMG

## 5. Mbledhja e Jashtzakonshme e Bordit nr. 21.1/11 e mbajtur me 14 Shtator 2011

Mbledhja e jashtëzakonshme e Boridt është mbajtur për shkak të aprovimit të Bordit të Vendimit për lejimin e blerjes së një poli të ndërprerësit 400kV nga ana e KOSTT-it. Mbledhja e jashtëzakonshme e Bordit u mbajt për shkak të defektit të riparueshëm në polin e ndërprerësit 400 kV në fushën gjeneratorike G2 në TS Kosova B me datën 23.08.2011. Bordi u informua se për aftësimin e kësaj fushe KOSTT-i është detyruar që urgjent ta siguroj një pol të këtij ndërprerësi me karakteristika të njëjta si poli ekzistues. Nga Bordi është kërkuar që të pajtohet me aprovimin e blerjes bazuar në arsyeshmërinë e prezantuar nga Kryeshefi Ekzkutiv sipas memos nga Drejtori i Operatori të Transmisionit të datës 13.09.2011.Bordi i Drejtorëve ka aprovuar vendimin për lejimin e blerjës së një poli të ndërprerësit 400kV me karakteristikat si poli ekzistues dhe ka udhëzuar shërbimet profesionale të KOSTT-it që të kryejnë zotimin e mjeteve financiare dhe prokurimin për këtë blerje.

## 6. Aktivitete të tjera

Drejtorët e Bordit të KOSTT-it në vazhdimësi kanë qenë në komunikim dhe bashkëveprim me menaxhmentin e KOSTT-it, që ka rezultuar me efiçiencë më të madhe në marrjen e vendimeve të nevojshme.

# Lista e shkurtesave

ATR – Autotransformatori

BK – Buxheti i Kosovës

BNJ – Burimet Njerëzore

ECLO – ( nga angl. European Commission Liaison Office) - Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian

ENTSO E - (European Network of Transmission System Operators for Electricity)- Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike

GjQ – Gjykata e Qarkut

IKP – Indikatorët Kyç të Performancës

KA – Konflikt Administrativ

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës

KfW- Banka Gjermane për Zhvillim

KOSTT- Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu

LP – Largpërçuesi

NS - Nënstacioni

NP – Ndërmarrjet publike

NJPMNP – Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike

OST – Operator i Sistemit të Transmisionit

PpE - Propozim për Ekzekutim

SCADA /EMS- (System Control and Data Acquisition/Energy Managament System) -Sistemi i kontrollit dhe grumbullimit të të dhënave/Sistemi i manaxhimit të energjisë

TP – Tatimi në pronë

ZRrE – Zyra e Rregullatorit të Energjisë